



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1119/10prot.

Datë 11 .05.2026

V E N D I M
Nr.622/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.567/2026, datë 29.04.2026, për procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. *REF-80814-04-02-2026*, me objekt “Organizim festash ne Bashkine Selenice”, me fond limit 4,166,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2026, nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenice.

Ankimues: Operatori ekonomik “Think Advertising” SHPK *NIPT L51315025S*, dhe adresë: *Rruga Besim Alla , pallati Noli nr.65, Garazhd kati (1)*.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Selenicë; Adresa: *Rruga “Llambi Bombaj”, Selenicë*.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar , Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 29.04.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.567/2026, ku vendosi:

Vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Think Advertising” SHPK, për procedurën e prokurimit E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-80814-04-02-2026 me objekt “Organizim festash ne Bashkine Selenice”, me fond limit 4,166,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2026, nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenice.*
 2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
 3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
 4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Think Advertising”.*
 5. *Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë*

I.2. Me shkresën nr. 1195/1 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1119/7 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë njofton se ka zbatuar vendimin nr.567/2026, datë 29.04.2026 dhe ka bashkëlidhur “Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit”, si dhe gjithashtu kërkon lejimin për vijimin me hapa të mëtejshëm për procedurë prokurimit.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 1195/1 prot., datë 04.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1119/7 prot., datë 07.05.2026, autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë njofton se ka zbatuar vendimin nr.567/2026, datë 29.04.2026 dhe ka bashkëlidhur “Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit”, si dhe gjithashtu kërkon lejimin për vijimin me hapa të mëtejshëm për procedurë prokurimit.

II.2. Nga verifikimi i sistemit elektronik (APP) si dhe referuar shkresës me 1195/1 prot., datë 04.05.2026 te autoritetit kontraktor, Komisioni, konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka bërë publikimin e shtojcës për “Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit”, të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor Bashkia Selenicë nuk ka zbatuar vendimin Nr. 567/2026, datë 29.04.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt ankimi “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF-80814-04-02-2026 me objekt “Organizim festash ne Bashkine Selenice”, me fond limit 4,166,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2026, nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenice.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1.Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me nr. REF-80814-04-02-2026 me objekt “Organizim festash ne Bashkine Selenice”, me fond limit 4,166,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 15.04.2026, nga autoriteti kontraktor Bashkia Selenice.

2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën “Njoftimin për ndryshimin e dokumentave të tenderit”.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

